



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog
Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

DATË/A:	26.06.2015
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Komisionin për RIK 50 ZK Nën-Komisionin për Lot 1
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Bashkim Shaqiri, Kryetar i komisionit RIK 50 ZK
NGA/OD/FROM:	Armend Gashi, Menaxher i Projektit RIK 50 ZK, Lot 1
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kronologjia e punës në projektin e RIK 50 ZK, Lot 1

Bazuar në punën e realizuar në projektin e RIK-ut në 50 ZK, përkatësisht Lot 1. Raportoj për realizueshmërinë e projektit si vijon:

- Si faze e parë e projektit të RIK-ut është Fushata e Informimit Publik. Kjo fushatë është zhvilluar konform UA. 04/12 nën udhëheqjen e z. Avni Ahmetit, UD Drejtorit të Kadastrit, me kërkesë të Komisionit për RIK, ku janë informuar qytetarët për fillimin e projektit të RIK-ut. Fushata e Sensibilizimit të Publikut është zhvilluar në 25 Zona Kadastrale në 5 Komuna në të cilat është zhvilluar projekti. Në takime me qytetar kanë marr pjesë: z. Avni Ahmeti, UD Drejtorit të Kadastrit, z. Nadir Shyqeriu, Ekspert Ligjor dhe z. Vllaznim Vuçitërrna, Menaxheri i projektit nga AKK si dhe zyrtar nga ZKK-së dhe përfaqësues nga OE. Ndërsa me fillimin e Informimit Publik:
 - Janë Informuar zyrtarët dhe drejtorit e Zyrave Kadastrale Komunale të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në zgjedhjen e ZK të cilat përfshihen në projekt.
 - Informimi është bërë përmes pllakateve dhe fletëpalosjeve të shpërndara në 25 ZK, mediave lokale, formës së shkruar si dhe përmes ueb-faqes së AKK-së dhe ueb-faqeve të KK në të cilat zhvillohet projekti. Informimi është bërë në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze ku janë ftuar qytetarët së paku 7 ditë përpara për mbajtjen e takimit me Komisionin si dhe përfaqësuesit e OE.

- OE ka siguruar hapësirat e përshtatshme për mbajtjen e takimit me banorët e ZK. Në takim, qytetarët janë Informuar për: rëndësinë e projektit, planin e rindërtimit, dinamikën e realizimit, detyrat e AKK-së, detyrat e ZKK-së, përbërja dhe detyrat e Komisionit, detyrat e OE dhe detyrat e qytetarëve të ZK.
- OE dhe Antarët e zonave kadastrale kanë bërë informim para fillimit të matjeve nëpër secilën zonë kadastrale, që pronarët ti përgatisin kufijtë e parcelave të tyre për arsye që kur të filloje me matjen e tyre mos të hasim në vështirësi. Ky proces varët shumë sa rëndësi i ka kushtuar antari i ZK/përfaqësuesi i fshatit/qytetit rreth informimit të qytetarëve.
- OE deri më datë 16.06.2016, ka dorëzuar të dhëna për këto zona kadastrale: Gllanasellë, Likoshan dhe Fushticë e Epërme, KK Glllogoc; Klinë e Mesme, Kryshevc, Aqarevë dhe Marinë, KK Skenderaj; Reshtan dhe Peqan, KK Suharekë; Istog, Lubovë, Staradran dhe Kovragë, KK Istog. Ndërsa për 12 zona kadastrale OE nuk ka dorëzuar të dhëna. Procesi i Kontrollit është realizuar dhe është duke u realizuar në bazë të kornizave të punës nr. AKK 01/2013 dhe 02/2013 dhe listave të kontrollit të kualitetit (Check-listat), të cilat janë të hartuara nga ekspertët e AKK-së dhe BB-së bazuar në udhëzimet dhe katalogët e AKK-së.
- Matjet në terren për momentin janë duke u zhvilluar në zonat kadastrale Prekaz i Epërm, KK Skenderaj dhe Suharkë, KK Suharekë.
- Bazuar në vendimet e Komisionit Shiqimi Publik ka filluar për zonat kadastrale Peqan, Gllanasellë, Likoshan dhe Fushticë e Epërme ndërsa nga data 27.06.2015 do të filloj Shiqimi Publik për zonën kadastrale Reshtan.

Me respekt,